

URDHËR

*Për vijimin e procesit akademik gjatë semestrit të dytë të vitit akademik 2019 -2020,
në kushtet e gjendjes së jashtëzakonshme, shkaktuar nga përhapja e COVID-19*

Nr. _____ Prot.

Tiranë më 23/03/2020

Drejtuar: Personelit akademik dhe administrativ
Studentëve të UET

Në zbatim të ligjit 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", statutit të institucionit, duke marrë shkas nga vendimi nr.190, datë 19.03.2020 i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për "Mbylljen e veprimtarisë së institucioneve arsimore publike dhe jo publike dhe çerdheve për kufizimin e përhapjes së infeksionit COVID-2019", Universiteti Europian i Tiranës në zbatim të këtij urdhëri, ka pezulluar mësimin në auditore deri në datë 3 Prill 2020.

Referuar situatës së jashtëzakonshme, dhe nevojës për vijimin e procesit mësimor,

URDHËROJ:

1. Zhvillimin e mësimin online për semestrin e II-të, viti akademik 2019-2020, përmes platformës UET LMS (Learning Management System) dhe Microsoft Teams.
2. Të përditësohen materialet në LMS nga secili pedagog, dhe të zhvillohen leksionet dhe seminarët përmes Microsoft Teams çdo javë, sipas orarit të mësimin të Sem II-të. Aty ku nuk evidentohen përplasje orari, studentët mund të grupohen në të njëjtën fashë orari mësimi, duke njoftuar përkatësisht studentët për orarin e zhvillimit të mësimin.
3. Vlerësimi i studentëve do të kryhet sipas tipologjisë së lëndëve:
 - a. Komponentët e vlerësimin për lëndët e Tipologjisë I, Bachelor dhe Master do të jenë:
 - i. Detyrë praktike nr 1- 30 pikë (dorëzohet përmes platformës UET LMS)
 - ii. Detyrë praktike nr 2- 30 pikë (dorëzohet përmes platformës UET LMS)
 - iii. Provimi përfundimtar – 40 pikë
 - b. Komponentët e vlerësimin për lëndët e Tipologjisë II, Bachelor dhe Master do të jenë:

- i. *Aktivizimi në leksionet & seminarët online (përmes Microsoft Teams), shkalla e përdorimit të LMS; detyrat praktike që mund të jepen nga pedagogët sipas specifikave të lëndës – 10 pikë;*
 - ii. *Detyra e kursit/ese (dorëzohet përmes platformës UET LMS) – 20 pikë*
 - iii. *Provimi përfundimtar – 70 pikë*
4. Zhvillimi përmes të njëjtave platforma të Seancave Metodologjike për studentët që janë caktuar të shlyejnë detyrimin përmblyese akademike, nëpërmjet temës së diplomës, përkatësisht në ciklet Bachelor, Master i Shkencave dhe Master Profesional. Sencat do të zhvillohen çdo ditë të premte, për 10 javë konsekuive, sipas orarit të shpallur nga sekretarja e përgjithshme. Për pjesën tjetër të studentëve të programeve të studimit me karakter profesional, Bachelor dhe Master Profesional, koordinatore të duhet të shpërndajnë literaturën orientuese të Provimit të Përgjithshëm Përfundimtar, pas miratimit nga Përgjegjësi i Departamentit.
5. Të mos aplikohen penaltetet për vonesat e kryerjes së pagesës së tarifës së shkollimit, deri në normalizimin e situatës.
6. Të vijojë aplikimi për Bursa Studimi, pararegjistrimi online, duke përfutur dhe nga reduktimet e tarfiave, sipas vendimit në fuqi të administratorit të shoqërisë.
7. Ngarkohen Zëvendës Rektorët, Sekretarja e Përgjithshme, përgjegjësit e departamenteve për monitorimin e zbatimit të këtij urdhëri nga personeli akademik me kohë të plotë dhe të pjesëshme. Ecuria e zhvillimit të mësimin online të raportohet në përfundim të çdo jave.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

Rektor

Prof. Dr. Nevlia NIKA

